



Gjatë muajit Maj: Ndahen çmimet e konkursit #TiranaSpring, në një ceremoni te Reja me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë, Z. Veliaj, fitueseve dhe sponsorëve.

Të tjera: Çfarë të bësh në Maj në Tiranë; Hapja e Muzeut "Shtëpia me Gjethe etj



[Fituesit e konkursit #TiranaSpring](#)

Shpallen fituesit e konkursit të dytë të fotografisë #TiranaSpring organizuar nga Visit Tirana, portali turistik i qytetit. Konkursi synonte promovimin e stinës së bukur të pranverës në qytetin tonë, duke postuar fotot më të bukura të fotografuara nga njerëz të thjeshtë. Rreth 400 foto u postuan ne kanalet sociale të VisitTirana.

Fituesit e konkursit #TiranaSpring u prezantuan në një ceremoni të mbajtur te Reja, në 30 Maj 2017 me praninë e Erion Veliaj.

Çmimi i parë: Rovena Plaku

Çmimi i dytë: Aldo Bonata

Çmimi i tretë: Alla Simacheva



[Çfarë të bësh në Maj në Tiranë](#)

Maji është i mrekullueshëm! Pranvera është në kulmin e saj. Moti është shumë i ngrohtë dhe pjesa më e bukur është se njerëzit dalin argëtohen deri në orët e vona të mbrëmjes, duke mbushur baret, restorantet dhe parqet e qytetit.

Ndonjëherë e quajmë si muajin e parë të verës, sepse njerëzit vishen hollë, me sandale dhe gjatë fundjavave shkojnë në Durrës për të bërë plazh. Gjithashtu, fundjavat në zonat rurale .



[Hapet Muzeu Shtëpia e Gjetheve](#)

Shtëpia e Gjetheve, zyra famëkeqe e Sigurimit të Shtetit gjatë regjimit diktatorial, më në fund u hap për publikun në 23 Maj 2017. Kryeministri Edi Rama inaguroi muzeun e shtuar së fundmi si një thesar i kujtesës tonë kolektive. Muzeu ndodhet në qendrën e Tiranës përballë Katedrales Ortodokse, e cila ka tashmë ka shtuar kurizitetin e shqiptarëve dhe turistëve.

[Dita Ndërkombëtare e Xhazit dhe udhëtimi i paharrueshëm me tren](#)



Muzikë dhe vallëzime nën ritmet e Xhazit. Ky ishte event i fantastik i quajtur "Andrra n'Tren", i organizuar më 30 Prill nga Hemingway Fan Club Albania me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Xhazit. Një grup të rinjsh e të rejash, adhurues të muzikës Xhaz, u mbledhën në stacionin e trenit në Vorë dhe u nisën për në Shkodër.

[Bienalja e artistëve të rinj nga Europa dhe Mesdheu, Mediterranea 18](#)



Për herë të parë, Shqipëria u bë vendi mikpritës i Bienales së Artistëve të Rinj nga Europa dhe Mesdheu, Mediterranea 18, një ekspozitë ndërkombëtare multidisiplinore që zhvillohet çdo dy vite në vende të ndryshme të Europës me artistë të rinj nga mosha 18-34 vjeç

[Dita Ndërkombëtare e Muzeve-Hyrje falas në muzetë kombëtare në Tiranë](#)



Që prej vitit 1977, më 18 maj në të gjithë botën festohet Dita Ndërkombëtare e Muzeve. Tema e Ditës Ndërkombëtare të Muzeve për vitin 2017 është; Muzetë dhe historitë tabu (ose historitë e kontestuara apo historitë e debatuar). Në kuadër të kësaj dite, Ministria e Kulturës njoftoi hyrjen falas për publikun në të gjitha muzetë kombëtare në Shqipëri.

[Evente të pritshme në Qershor](#)



- Shend e Verë (1 Qershor), aktivitete për fëmijë në Parkun e Madh
- Mbrëmja e parë perkujtimore mbi Falco-n në Shqipëri (2 Qershor)
- Ekspozita "Tjetërsim" në Galerinë Kombëtare të Arteve" (2-23 Qershor)
- FirstWave Festival, kamping dhe muzikë elektronike te Liqeni i Tiranës (2-4 Qershor)
- "Piknik me Moxartin" piknik dhe aktivitete sportive te Liqeni i Farkës (3 Qershor)
- 10 Netët e Kinemasë Italiane 2017 te Reja (30 Maj-1 Gusht)

[Eventet e muajit Maj në Tiranë](#)

- Dita Kombëtare e Vajit të Ullirit në Pazarin e Ri (10 Maj)
- Edicioni i tretë i DocuTIFFF (10-17 Maj)
- Modele të Qëndrueshme të Konservimit Urban dhe Rijetësimit të fshatrave historikë, te Reja (11 Maj)
- Maratona Vrapo për Europën (11 Maj)
- Lukrecia Borxhia në Teatrin Kombëtar (12-28 Maj)
- Premiera Së Prapthi te Teatri Metropolit (13-14 Maj)
- Dita Kombëtare e Vajit të Ullirit në Pazarin e Ri (10 Maj)
- Edicioni i tretë i DocuTIFFF (10-17 Maj)

Reklamoni në portalin tonë
[Visit-Tirana.com](http://www.visit-tirana.com)



Kontaktoni në:
Tel: +355 4 5800419

Për më shumë artikuj unikë gjatë gjithë muajve klikoni në: <http://www.visit-tirana.com/sq/lajme>

Visit Tirana Rr. "Sami Frashëri", Nd.30, H.2, Ap.8, Tiranë

Tel: +355 4 5800419, Email: contact@visit-tirana.com; Web: www.visit-tirana.com

Follow us:

